



## Përbledhje e studimit

Vlerësimi i Grupit të Kolegëve si një mjet i Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor për ekipin e Kujdesit Shëndetësor Parësor



## Përbajtja

KONTEKSTI .....	3
QËLLIMI I STUDIMIT .....	3
QËLLIMET SPECIFIKE.....	4
METODOLOGJIA .....	4
GJETJET .....	4
PËRFUNDIME:.....	6

## KONTEKSTI

Projekti “Shëndet për të gjithë” (Health for All Project - HAP) i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, ka prezantuar dhe mbështetur ngritjen dhe funksionimin e Grupeve të Kolegëve si një formë e re e Edukit të Vazhdueshëm Mjekësor në Shqipëri që prej vitit 2015 në qendrat e kujdesit parësor shëndetësor në qarkun Dibër dhe Fier. Grupet e Kolegëve janë një nga llojet e aktiviteteve edukuese në vendin e punës nëpërmjet të cilit, mjekë dhe infermierë të së njëjtës Qendër Shëndetësore, por jo vetëm, takohen sipas një plani të paracaktuar për të diskutuar mbi çështje të ndryshme të praktikës së tyre klinike dhe menaxheriale të përditshme. Mjekët dhe infermierët mund të organizohen në grupe kolegjesh sipas profesionit ose në grupe ndër-profesionale, me pjesëmarrjen e përbashkët të mjekëve dhe infermierëve.



Grupet e Kolegëve si një formë e EVM-së të profesionistëve të shëndetësisë njihet nga QKEV-ja si “Grup rishikimi” sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 788, datë 22.9.2015 (ndryshuar me VKM nr.304, datë 5.4.2017; nr.418. datë 4.7.2018) “Për përcaktimin e kritereve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”, pika 4.6 që lexon: “Grup rishikimi”, është një aktivitet në grup të vogël (5-10), ku profesionistët e të njëjtit specialitet ose shërbim mblidhen për të diskutuar për çështje kryesore që lidhen me praktikën e tyre klinike, me cilësinë e shërbimit dhe zgjidhjet e mundshme. Qëllimi kryesor i grupeve të rishikimit është shkëmbimi i përvojave dhe vlerësimi i punës së njëri-tjetrit, zgjidhja e problemeve praktike, hartimi i udhëzuesve për të përmirësuar shërbimin. Grupet e rishikimit mblidhen rregullisht dhe drejtohen nga një drejtues grupi”

## QËLLIMI I STUDIMIT<sup>1</sup>

Përfthimi i informacionit shkencor lidhur me efektivitetin dhe eficencën e Grupit të Kolegëve si një mjet i edukimit të vazduar mjekësor për ekipo e kujdesit shëndetësor parësor për ta vënë në dispozicion të MSHMS-së, OSHKSH-së, QKEV-së, Urdhërave dhe Shoqatave të Profesionistëve për nxitjen e tyre për shtrirjen e kësaj përqasjeje të trajnimit në vendin e punës në të gjitha organizatat-ofruese të kujdesit shëndetësor, parësor dhe spitalor në shkallë kombëtare.

<sup>1</sup> Studimi u zhvillua nga Klevis Caushaj, student i programit Master në Menaxhim Shëndetësor në kuadër të mbështetjes që HAP ofron përritjen e kapaciteteve kërkimore të studentëve.

## QËLLIMET SPECIFIKE

- Të dëshmohet:
  - eksperiencia në ngritjen dhe funksionimin e GK si një mjet i Edukimit të vazhdueshëm mjekësor për ekipin mjek familje-infermjer në QSH-të e qarkut Dibër dhe Fier
  - impakti i GK në praktikën e përditshme të ofrimit të kujdesit mjekësor dhe infermjeror në Qendrat Shëndetësore në qarkun Fier dhe Diber.
- Të identifikohen mësimet e nxjerra në mënyrë që të konsolidohet eksperiencia e GK në dy qarqet Fier dhe Dibër, dhe të nxitet shtrirja e kësaj eksperience në nivel kombëtar.

## METODOLOGJIA

“Vlerësimi i Grupit të Kolegëve si një mjet i EVM për ekipin e Kujdesit Shëndetësor Parësor” është studim transversal i tipit sasior nëpermjet një pyetësori të strukturuar që u plotësua on line nga drejtuesit/facilitatoret (Mjekë dhe infermjerë) e GK të QSH-ve në qarkun Fier dhe Dibër.

1. **Qarku Dibër:** 59 mjekë të përgjithshëm/familje dhe 507 infermierë ofrojnë shërbimin shëndetësor parësor për një popullsi prej 137,062 banorësh
2. **Qarku Fier:** 165 mjekë të përgjithshëm/familje dhe 624 infermierë ofrojnë shërbimin shëndetësor parësor për një popullsi prej 310,331 banorësh

Pyetësori është një instrument origjinal që është zhvilluar nga HAP-i në periudhën prill-qershor 2019, përfshirë dhe testimin paraprak të tij. Ky pyetësor iu drejtua për plotësim “on line” të gjithë facilitatoreve të GK në qarkun Fier dhe Dibër që kishin mbyllur të paktën një cikël takimesh për një GK (gjithsej 141 deri me 4 korrik 2019).

Mbledhja e të dhënavë u bë online në periudhën 5-20 korrik 2019, me pjesëmarrjen e 109 facilitatoreve të GK (77%) nga një total prej 141 të tillë në qarkun Fier dhe Diber.

Mbledhja e të dhënavë u pasua me përpunimin dhe analizën e tyre në SPSS, si dhe përgatitjen e raportit me gjetjet dhe konkluzionet/rekomandimet.

## GJETJET

### Profili i të anketuarve

**Numri i pjesëmarrësve në studim ishte 109,** ku përqindja më e madhe e tyre ishte femra (89.9%). Përqindja e pjesëmarrësve sipas qarqeve përkatëse ishte shpërndarë në mënyrë thuajse të barabartë. Përqindja më e madhe e pjesëmarrësve të studimit ishin infermiere (68.8%) e pasuar nga mjekë të përgjithshëm (17.4%), infermier-mami (11%) dhe mjekë familje (2.8%).

Rreth 62% e pjesëmarrësve kishin më shumë se 5 vjet pune si profesionist në KSHP dhe vetëm 5.5% kishin më shumë se një vit dhe më pak se dy vjet pune si të tillë. 30% e pjesëmarrësve kishin si detyrë kryesore konsultën mjekësore në QSH dhe shërbimin në komunitet, 26.6% shërbim në komunitet dhe rreth 15% vetëm konsulta mjekësore në QSH.

**Mosha mesatare e pjesëmarrësve në studim ishte 35.5 vjeç.**

**Eksperiencia me drejtimin e Grupit të Kolegëve:** 46.8 % e pjesëmarrësve në studim raportuan që kanë drejtuar të paktën një Grup Kolegësh. 27,5% e pjesëmarrësve kishin drejtuar 2 grupe dhe 27.7 % kishin drejtuar më shumë se 2 grupe.

52% e pjesëmarrësve kishin drejtuar GK me mjekë dhe infermierë së bashku, ndërsa rreth 49% kishin drejtuar Grupe të Kolegëve vetëm me infermierë.

Dy arsyet e para që kanë ndikuar në vendimin e pjesëmarrësve në studim për të qenë facilitator grupi dhe në vendimin e kolegëve për të qenë anëtarë të Grupeve të Kolegëve janë zhvillimi profesional dhe përmirësimi i perfomancës në punë.



Të aketuarit e lidhin kontributin e anëtarëve në mbarëvajtjen e Grupit, me pjesëmarrjen e tyre rregullisht në takime (96.3%), me pjesëmarrjen aktive në diskutimet në Grup (95.4%) dhe me qëndrimin bashkëpunues dhe mbështetës të anëtarëve të grupit (90.8%).

Tre vështirësítë më të shpeshta gjatë funksionimit të GK-ve të pohuara nga pjesëmarrësit në studim janë:

- mungesa e kompjuterit (41.3%),
- vështirësítë në vlerësimin e nevojave për trajnim (40.4%),
- mungesa e materialeve në gjuhën shqipe (31.2%)

GK është një mjet praktik dhe efektiv i EVM-së:

- GK krijon mundësinë për thellimin e njohurive dhe përmirësimin e aftësive praktike (100%)
- Mundëson shkëmbimin e eksperiencave më të mira midis kolegëve (97,3%)
- Mundëson standardizimin e praktikës klinike me protokollët e mjekimit (97,2%)
- GK funksionon në orare që nuk pengon punën e përditshme dhe në ambjentet e punës të QSH-së (94,5%)
- Rrit bashkëpunimin mjek-infermjer dhe përmirëson komunikimin ndërmjet kolegëve (92%)
- Pjesëmarrësit janë të bindur që ta rekomandojnë GK tek kolegët e tyre që punojnë në QSH dhe spitale (98%)
- Pjesëmarrësit janë të sigurtë për të vazhduar me Grupet e Kolegëve (92.7%)

GK përmirëson praktikën e përditshme të kujdesit shëndetësor:

Pjesëmarrësit në studim kanë treguar që GK ka përmirësuar praktikën e përditshme të kujdesit shëndetësor parësor lidhur me:

- **Parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve jo të transmetueshme, duke:**
  - bërë rutinë matjen e perimetrit të belit dhe të presionint arterial te çdo pacient mbi 18 vjeç pamvarësish arsyesh së konsultës mjekësore.
  - standartizuar vlerësimin dhe ndjekjen e patientëve diabetikë dhe me hypertensionin arterial
  - përshkruar barnave kundër yndyrnave bazuar në vlerësimin e riskut KV

- **Kujdesin për fëmijët nëpërmjet:**
  - Zbatimit të praktikës së vlerësimit të rritjes së fëmijëve sipas kurbave të rritjes
  - menaxhimit të integruar të sëmundjeve të fëmijëve 0-5 vjeç
  - informimit dhe këshillimit më të mirë të prindërve mbi ushqyerjen e fëmijëve deri 2 vjeç
  - vaksinimin e fëmijëve 0-18 vjeç .
- **Ndrekjen e gruas shtatzënë nëpërmjet:**
  - standardizimit të ndrekjes së gruas shtatazënë dhe pas lindjes sipas Protokolleve të praktikës klinike të kujdesit antenatal
  - monitorimit të përvjetorit të respektimit të standardit "konsultimi i parë i gruas shtatzënë" gjatë tremujorit të parë"
- **Aftësimin në përdorimin e pajisjeve mjekësore, si EKG-ja, puls-oksimetri, oftalmoskopi dhe në përgjithësi pajisjet e çantës së infermierit.**



Faktorët që ndihmojnë dhe pengojnë zbatimin e përmirësimeve të praktikës klinike:

Tre faktorët kryesorë që kanë **ndihmuar** zbatimin e përmirësimeve të praktikës klinike janë:

- Motivimi i anëtarëve të grupit për performancë më të mirë
  - Drejtuesi i QSH është anëtar i GK-së
  - Vendimet e GK-së merren me dakortësinë e çdo anëtar
- Tre faktorët kryesorë që kanë qenë **pengesë** për zbatimin e përmirësimeve të praktikës klinike janë:
    - mungesa e pajisjeve mjekësore përkatëse
    - mungesa e mbikqyrjes mbështetëse në vendin e punës
    - numri i madh i vizitave mjekësore gjatë 3 orëve të para të ditës

Institucionet që mund të mbështesin ngritjen dhe funksionimin e Grupeve të Kolegëve:

- QKEV-ja dhe koordinatorët lokal të saj
- Përfaqësuesit lokal të Urdhrit të Infermierëve dhe
- Shoqatat e profesionistëve mjekësorë
- Përfaqësuesit lokal të Urdhrit të Mjekë

## PËRFUNDIME:

Për konsolidimin dhe shtrirjen në shkallë kombëtare të eksperiencës së suksesshme të GK-ve, të dhënrat e studimit tregojnë që ka shumë rol krijimi në nivel sistemi dhe ofruesi të kujdesit

shëndetësor të një ambjenti mbështetës dhe nxitës për t'i dhënë fryshtë motivimit që ka personeli në KSHP për zhvillim profesional dhe performancë më të mirë në punë.

Në nivel sistemi janë të rëndësishme për ngritjen dhe funksionimin e Grupeve të Kolegëve në shkallë kombëtare:

- nxitja dhe aftësimi i koordinatorëve lokalë të QKEV-së, i përfaqësuesve lokalë të Urdhrit të Infermjerit, Urdhrit të Mjekut dhe Shoqatave të profesionistëve;
- informimi sistematik dhe aksesi i profesionistëve shëndetësorë për burime online të materialeve shqip, dhe
- aftësimi i facilitatorëve të GK-ve në raportimin te QKEV-ja, në moderimin e takimeve dhe në “të menduarit kritik” në vlerësimin e nevojave për trajnim dhe përcaktimin e çështjes së bashku me grupin.

Në nivel ofruesi të kujdesit shëndetësor krijimi i ambjentit mbështetës dhe nxitës për mbarëvjetjen e GK, nënkuption:

- pajisjet bazë mjekësore për mjekun dhe infermijeren,
- pajisje të teknologjisë së informacionit,
- mbikqyrjen mbështetëse dhe motivuese në vendin e punës si dhe
- planifikimin e vizitave në KSHP.

Ky studim u mbështet nga Projekti Shëndet për të Gjithë i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC i cili zbatohet nga Insituti Zviceran Mjekësisë Tropikale dhe Shëndetit Publik (Swiss TPH) përmes Qendrës HAP. Opinionet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht opinionin e HAP, SDC dhe Swiss TPH.

Një Projekti i i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC**

Zbatuar nga:

**Swiss TPH**   
Swiss Tropical and Public Health Institute